

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Kryesia

Prishtinë, 4 dhjetor 2019

Njoftim për opinion

Shpallja e djeshme e rezultateve të PISA-s (Program for International Student Assessment \ Program i Vlerësimit Ndërkombëtar i Nxënësve) ishte dëshpërim për të gjithë qytetarët e Kosovës, me përjashtim të atyre që do të duhej të mbanin përgjegjësinë objektive për këtë gjendje. Arsimi është njëri nga dështimet tona të mëdha, por moskokëçarja dhe reagimi i vakët institucional në këtë rast e bën situatën edhe më dëshpëruese, duke i dhënë asaj përmasat e një krize shoqërore, përfshirë edhe krizën morale. Kriza në arsim është kriza më e madhe e shoqërisë kosovare që në fillimet e perspektives së saj, sikundër që është zhgënjim dhe braktisje e pashembullt e idealizmit tonë historik, i mbështetur mbi idetë e iluminizmit dhe emancipimit.

Nxënia e dijeve nuk është dështimi i vetëm në arsim, ai është vetëm një segment i dukshëm dhe i afishuar në një mënyrë të tillë, që na bën të turpërohem dhe të skuqemi të gjithë. Mungesat dhe dështimet tona janë shumë më të mëdha dhe kjo situatë na bën me dije se Kosova është e përfshirë prej shumë vitesh në një krizë të mësimi dhe të dijes, e cila si shtet dhe si komb na lë pa të ardhme. Testi i PISA-s nuk është dhe nuk mund të merret si komponentë artificiale e arsimit, siç pretendojnë institucionet tona. Ai është një indikator që tregon një gjendje dhe nuk është asnjëherë qëllim i vetvetes, që flet qartë se ka ardhur koha për të marrë përgjegjësi, ngase kjo krizë nuk amnistion askënd. Vetëm se, një përgjegjësi kaq e gjerë nuk do të thotë se shoqëria jonë nuk i ka të identifikuar bartësit kryesorë të shkatërrimit në arsim dhe se ata nuk janë tashmë anonimë. Ata kanë adresë, ata i njohim të gjithë: në radhë të parë janë ata që kanë marrë përgjegjësitë politike dhe institucionale për ta qeverisur vendin.

Për të dalë nga kjo gjendje, qeverinë në ardhje e pret një punë e vështirë: të shpallë gjendjen emergjencë kombëtare dhe të marrë masat përkatëse, fillimisht duke i mënjeluar nga strukturat vendimmarrëse të gjithë ata që janë identifikuar si bartës proceseve negative dhe njëkohësisht duke krijuar mekanizma institucionale për ta avancuar procesin arsimor. Është krejtësisht e qartë se ata që e kanë shkaktuar këtë krizë, nuk mund ta luajnë edhe rolin e shpëtimtarëve.

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, në kuadër të përgjegjësisë të veta dhe në bashkëpunim me të gjithë subjektet relevante e me njohës të kësaj fushe, brenda një periudhe 6 mujore do të hartojë një dokument gjithëpërfshirës për gjendjen në arsim, duke propozuar edhe masat përkatëse. Akademia do të jetë në dispozicion, për t'u bërë pjesë e rrugëdaljes nga kjo emergjencë kombëtare.

Për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,

Akademik Mehmet Kraja, kryetar

